

## **Fjalimi i Kryetarit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri në Këshillin e Përhershëm të OSBE-së.**

**Vjenë, 19 tetor 2000**

Zonja Kryetare, të Nderuar Përfaqësues të Përhershëm,

Ky takim i Këshillit të Përhershëm zhvillohet në kulmin e sezonit zgjedhor në Ballkan. Përfundimi së fundi i zgjedhjeve për pushtetin vendor në Shqipëri tërhoqi më pak vëmendje se të tjerët në rajon. Shpeshherë mungesa e lajmeve është pozitive. Por, domethënia e zgjedhjeve në Shqipëri, si në shkallë kombëtare ashtu edhe për rajonin si i tërë, nuk duhet të nënvlerësohet.

Së pari, këto ishin zgjedhjet e para në Shqipëri që nga zgjedhjet parlamentare të vitit 1997 dhe zgjedhjet e para vendore për katër vjet. Ato u zhvilluan nën një Kushtetutë të re, një Kod të ri Zgjedhor, dhe një Komision Qëndror të ri të Zgjedhjeve. Për herë të parë, lista e votuesve u përgatit mbi bazën e një regjistri votuesish të kompjuterizuar. Prezenca e OSBE-së u përfshi nga afër në përgatitjen e këtyre zgjedhjeve nga fillimi në fund. Rëndësia e tyre u vlerësua nga ODIHR-i, i cili së bashku me Këshillin e Evropës, dërguan maksimumin e mundshëm të vëzhguesve ndërkombëtarë për të monitoruar vetë zgjedhjet. Gjykimi i tyre, se zgjedhjet shënuan një përparim domethënës për arritjen e standarteve të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së, flet vetë. Fakti se ato u zhvilluan në një atmosferë paqësore, pavarësisht nga tensionet e krijuara nga politikanë të caktuar, është një nderim për mirësinë e popullit shqiptar, si dhe për masat e marra nga autoritetet.

Këto janë fakte të zgjedhjeve, dhe si të tilla, ato përfaqësojnë një hap të rëndësishëm larg atmosferës së kërcënimit dhe mashtrimit, e cila ka shoqëruar kaq shpesh zgjedhjet në të kaluarën. Gjithashtu, ato janë natyrisht një tregues për zgjedhjet kombëtare që do të mbahen në qershorin e vitit tjetër. Në mënyrë të pashmangshme u bënë gabime për të cilat unë mendoj se janë nxjerrë mësim që do të zbatohen në të ardhmen. Ato në asnjë mënyrë nuk i zhvlerësojnë përpjekjet e bëra nga qeveria shqiptare së bashku me OSBE-në dhe partnerët e saj ndërkombëtarë, veçanërisht PNUD-i dhe IFES-i, për të siguruar se zgjedhjet përmbushnin standartet ndërkombëtare. Kryesisht, mangësitë ishin të një natyre teknike dhe kishin të bënin me vonesat rreth listës së votuesve dhe regjistrimit të kandidatëve, si dhe shpërndarjen e kartave të identifikimit të votuesve dhe përgatitjen e materialeve zgjedhore. Megjithatë, Partia Demokratike e opozitës ishte tepër e gatshme për të ngritur akuzat, ndonëse ata, së bashku me disa nga partitë e vogla kishin disa ankesa të justifikueshme. Ankesa kryesore e PD-së ishte rreth gabimeve dhe mungesave në listën e votuesve. Por, unë jam i kënaqur me faktin që akuza e bërë nga Partia Demokratike nuk ishte e themeltë që, si rezultat i manipulimit politik, i'u mohua e drejta e votimit në mënyrë masive dhe kryesisht votuesve të PD-së. Në fakt, u bë çdo përpjekje për të përfshirë në listën përfundimtare emrat e të gjithë votuesve potencialë, pavarësisht nga fakti nëse ata ishin verifikuar gjatë hartimit të listës. Pothuajse, të gjithë votuesit mundën të hidhnin votën e tyre ditën e votimit. Partitë e vogla, u ankuan kryesisht për mungesën e disa prej kandidatëve të tyre nga fletët e votimit dhe disa

prej tyre u zgjidhën tashmë në mënyrë të kënaqshme, ndërsa të tjerët janë duke i'u referuar Gjykatave.

Pas raundit të parë, ODIHR-i dhe Këshilli i Evropës i cilësuan zgjedhjet si një hap të rëndësishëm përpara të Institucioneve shqiptare dhe si një përmirësim krahasuar me zgjedhjet e mëparshme. Megjithatë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe gjykatat kanë treguar pak gatishmëri për të trajtuar shumë nga ankesat për parregullsitë që ata morrën dhe mbetet ende shumë punë riparuese për t'u bërë. Kjo nuk duhet të zhvlerësojë arritjet e përgjithshme të cilat duhet të ndihmonin për të rivendosur besimin e popullit shqiptar në proceset demokratike. Për arsye të përvojës së mëparshme me zgjedhje mjaft të çënuara, populli dukej se e kuptoi se këtë herë ishte në diskutim jo vetëm fati i komuniteteve të tyre vendore por edhe e ardhmja e Shqipërisë si e tërë. Komuniteti ndërkombëtar në deklaratat e tyre publike, i kujtonte në mënyrë të vazhdueshme zgjedhësve se këto ishin në të vërtetë zgjedhje për qeverisjen vendore dhe jo për atë qendrore dhe prandaj ata duhej të votonin në përputhje me këtë. Gjithashtu, është shumë herët të gjykosh për përgjigjen e përgjithshme, por në disa bashki të mëdhaja personalitetet vendore kanë fituar madje në bastionet e partive kundërshtarë.

Megjithatë, sukcesi i zgjedhjeve nuk duhet të mbulojë faktin se po pengohet ende procesi politik në Shqipëri nga refuzimi i Partisë Demokratike për t'ju përmbajtur konventave normale. Ajo nuk njohu Kushtetutën, Kodin Zgjedhor apo Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, megjithëse kjo nuk parandaloi kandidatët e saj për t'u regjistruar për zgjedhjet dhe për të marrë pjesë në raundin e parë. Mosnjohja nga ana e saj e rezultateve të raundit të parë të zgjedhjeve dhe vendosja e parakushteve të paarrtshme për të marrë pjesë në raundin e dytë janë përfundim logjik i një politike të mos-bashkëpunimit që edhe më herët pothuajse çoi në bojkot. Por këto janë simptomat e një sëmundjeje më të thellë të Partisë Demokratike.

Partia Demokratike nuk e ka pranuar kurrë disfatën e vet zgjedhore nga Socialistët në vitin 1997. Deri tani, ajo u kompensua për dobësinë e saj në Kuvend duke kontrolluar pothuajse të gjitha qytetet e mëdha, duke përfshirë edhe kryeqytetin, si dhe një pjesë të mirë prej dy të tretave të bashkive dhe komunave më të vogla. Këto fitore, të arritura gjatë zgjedhjeve vendore të vitit 1996, u përmbysën nga Partia Socialiste e cila tani ka mundësinë për të fituar kontrollin mbi Tiranën dhe të gjitha prej bashkive të mëdha përveç njëres, si dhe më shumë se pesëdhjetë për qind të fshatit. Partitë e vogla patën më tepër sukses se sa pritej, por jo në mënyrë të mjaftueshme për të ofruar një koalicion të vlefshëm për opozitën. Çfarëdo që të kenë qenë motivet e popullit për të votuar në zgjedhjet vendore, rezultatet shikohen në mënyrë të pashmangshme si një matës i saktë i fuqisë përkatëse të të dy partive kryesore politike në Shqipëri. Zhvendosja e qartë në kah të Socialistëve në nivelin vendor e risiguron Qeverinë, ndërkohë që mbas nëntë muajve ajo do të shkojë drejt zgjedhjeve kombëtare. Por, nuk është e dobishme për procesin demokratik në qoftë se partia kryesore opozitare është në përshtjellim dhe është e paaftë qoftë për të pranuar refuzimin e zgjedhësve, qoftë për t'u reformuar dhe për t'u modernizuar. Ekzistojnë elementë reformistë brenda PD-së, por deri më sot ata janë marginalizuar. Megjithatë, është ende shumë herët për të parashikuar nëse do të ishte i mundshëm ndonjë rigrupim pas zgjedhjeve. Retorika e urrejtjes u përdor nga të dyja palët gjatë fushatës, por është e rëndësishme të vihet re se kandidatët në shumë bashki dhe komuna praktikisht, bashkëpunuan me kundërshtarët e tyre duke bërë thirrje për zgjedhje të qeta dhe morrën pjesë në debatet publike me ta. Përsa i përket raundit të dytë të zgjedhjeve, incidentet në qytetin bregdetar të Himarës në jug të vendit i lanë në hije ngjarjet e tjera. Kjo qytezë është vendbanimi i një numri qytetarësh greqisht-folës dhe PS-ja dhe PD-ja formuan

një aleancë për t'ju kundërvënë Partisë kryesisht greke të të Drejtave të Njeriut. Nga ana e tyre, grekët dërguan një delegacion prej 6 deputetësh plus përfaqësues të tjerë të Parlamentit grek për të vizituar Himarën për vëzhgimin e zgjedhjeve. Duket sikur pati parregullsi. Unë i referohem raporteve të misioneve monitoruese. Duket se vazhdon një farë tensioni rreth kësaj çështjeje.

Përgjatë gjithë procesit zgjedhor, Prezenca e OSBE-së ka vepruar si një lehtësues dhe kritik, duke ndihmuar në hartimin e Kodit Zgjedhor, duke vënë theksin tek rreziqet për dispozita tranzitore të caktuara të bashkëngjitura atij në momentin e fundit, të cilat vinin në pyetje paanshmërinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka shërbyer për të marrë ankesat e politikanëve të opozitës dhe është dashur të përballet me pjesën e drejtë të kritikës që i takonte. Ashtu siç thashë rreth Kodit Zgjedhor në fjalimin tim të fundit përpara Këshillit të Përhershëm në qershor, duket shumë e dyshimtë, nëse do të ishte lënë në dorën e tyre, ligjvënësit shqiptarë do të mund të kishin prodhuar për Përmbledhjen e tyre të Ligjeve një dokument kaq gjithëpërfshirës dhe të përshtatshëm për zgjedhje moderne. OSBE-ja veproi si një pikë e vazhdueshme reference, duke ofruar kuadrin për konsultime midis Miqve të Shqipërisë dhe me ekspertët nga PNUD-i dhe IFES-i. Oficeri i Qeverisjes Vendore bashkërendoi dhe mbështeti ekipet vizitore të specialistëve nën Programin e Asistencës Zgjedhore të PNUD-it dhe organizoi misionin ndërkombëtar të vëzhgimit të rregjistrimit. Gjatë fushatës zgjedhore, Zyrat Rajonale të OSBE-së luajtën një rol të vlefshëm monitorues, duke i dhënë mbështetje logjistike vëzhguesve afat-gjatë dhe afat-shkurtër të ODIHR-it dhe luajtën një rol ndërmjetësimi, ndonjëherë qenësor, deri në prag të zgjedhjeve, veçanërisht rreth përbërjes së komisioneve të qendrave të votimit. Shpejtësia me të cilën Zyrat Rajonale shpesh, i'a arritën të komunikonin, i dha mundësinë Selisë së Prezencës për të parandaluar probleme serioze duke ndërhyrë në kohë në qendër. Duke patur parasysh rëndësinë e zgjedhjeve për këtë periudhë kohe dhe rolin që Prezenca ka luajtur, ka ende për të thënë por më lejoni që ta mbyll këtë pikë duke falënderuar vendet anëtare të cilat patën mirësinë të na ofronin neve vëzhguesit dhe monitorët. Kjo ishte e paçmueshme.

Ka një numër shenjash inkurajuese që Shqipëria po del nga e kaluara e saj zhgënjyese, në të cilën dukej se ajo ishte mbërthyer tre vjet më parë. Padyshim, zgjedhjet e fundit kanë kontribuar në ndjenjën se është bërë përparim. Në të njëjtën kohë, duhet të përgëzohet Qeveria Shqiptare e Kryeministrit Ilir Meta për përparim të prekshëm në një numër të rëndësishëm sektorësh duke kontribuar në stabilitetin e vendit dhe reformën e ekonomisë. Sukseset përfshijnë së pari dhe më kryesoren, rendin publik. Për shembull, një strategji e një qëndrimi të tërhequr e ndjekur nga policia gjatë fushatës zgjedhore, e kombinuar me vendosjen adekuate gjatë ditës së votimit, bëri shumë për të siguruar që zgjedhjet të kalonin të sigurt dhe pa shqetësime. Vëzhguesit e ODIHR-it raportuan se policia veproi në mënyrë profesionale dhe korrekte në të gjithë kohën dhe se asnjë ankesë nuk e morr nga publiku. Kjo është një arritje e shënuar duke marrë parasysh historinë e afërt të Shqipërisë. Gjithashtu, Qeveria është e angazhuar në reformat e shpejtuara të tregut dhe deçentralizimin dhe reformën e administratës publike. Privatizimi i sektorit bankar është pothuajse i përfunduar dhe ristrukturimi dhe privatizimi i telekomunikacioneve, sektorëve të energjitikës dhe minierave është duke përparuar me të njëjtin ritëm. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme nuk janë më nën kontrollin e shtetit. Qeveria është duke ndjekur një program madhor për riparimin dhe rindërtimin e rrugëve dhe një numër propozimesh për projekte të infrastrukturës janë marrë në konsideratë për t'u financuar nga BE-ja, Banka Botërore dhe organizata të tjera nën Paktin e Stabilitetit. Gjithashtu, është bërë përparim i konsiderueshëm në mbledhjen e taksave dhe kontrollin e të ardhurave nga doganat.

Pavarësisht përparimit të dukshëm, megjithatë, do të ishte gabim të nxirrje përfundimin se Shqipëria është tashmë e vendosur mirë drejt rrugës për demokratizimin e plotë të jetës së saj publike dhe rradhitjen eventuale me strukturat Evropiane. Ka ende shumë punë për të bërë në periudhën përgatitore të negociatave mbi Marrëveshjen e Asociimit dhe Stabilizimit me BE-në. Megjithëse, situata e sigurisë ka përparuar mjaft gjatë vitit të fundit, ajo është ende delikate dhe rënjtë e demokracisë janë ende të cekëta dhe të brishta. Është pothuajse e pamundur të arrihet një konsensus politik midis të dyja partive kryesore dhe opozita nuk po luan rolin e saj të plotë në administratë. Megjithë programin e qeverisë për të mbledhur armët, një sasi e konsiderueshme armësh dhe municionesh të vjedhura nga arsenalet në vitin 1997 vazhdojnë të mbeten jashtë kontrollit ligjor. Madhësia e kësaj çështjeje pasqyrohet në vendimin e marrë së fundi nga Kuvendi për të zgjatur afatet e fazës vullnetare të programit të mbledhjes së armëve edhe për dy vite të tjera. Korrupsioni mbete një problem dhe ne presim ende të shikojmë rezultate më konkrete të strategjisë anti-korrupsion të qeverisë, duke filluar me reformën e sistemit gjyqësor. Trafiku i paligjshëm i të gjithat llojeve vazhdon megjithë përpjekjet e qeverisë dhe ndihmën ndërkombëtare për ta frenuar atë. Varfëria rurale mbetet endemike.

Përsa i përket OSBE-së, Prezenca vazhdon të zbatojë mandatin e saj në Shqipëri sa më mirë që të jetë e mundur, por ashtu siç treguan shqetësimet që unë parashtrova ajo është ende shumë larg përmbushjes së detyrave të saj. Përparimi që është arritur që nga fillimi i punës së OSBE-së këtu mbetet ende i pamjaftueshëm dhe në të ardhmen Shqipërisë do t'i duhet çdo masë ndihme që mund të ofrohet nga komuniteti ndërkombëtar në rast se ajo do të bëjë kalimin në një mënyrë të sigurt drejt fazës së zhvillimit të saj të mëtejshëm. Pikërisht, këtu qëndron nevoja që Prezenca e OSBE-së të hartojë programin e saj për të ardhmen. Administrata e re e qeverisjes vendore duhet të forcojë demokracinë në bazë, por ajo do të ketë nevojë për mbështetje. Atëherë, qeverisja vendore duhet të rradhitet ndër çështjet e para të axhendës sonë në një kohë kur një brez i ri liderash politikë do të fillojnë të marrin përgjegjësitë e tyre të reja. Zyra e Qeverisjes Vendore do të vazhdojë të jetë e angazhuar në çështjet zgjedhore, por çështja kryesore e saj do të jetë ofrimi i këshillimit politik në zbatimin e ligjeve për decentralizimin dhe fuqizimit të qeverisjes vendore. Këtu ajo do të ndihmohet si në monitorim ashtu edhe në ndërmjetësimin politik nga ana e Zyrave Rajonale, të cilat kanë një përvojë unike të kushteve vendore në zonat e tyre të përgjegjësisë që mbulojnë dhjetë nga njëmbëdhjetë prefekturat jashtë Tiranës.

Zyra e Këshillimit Ligjor do të zgjerohet në mënyrë të plotë në monitorimin dhe zbatimin e ligjeve, duke përfshirë fazën pas-zgjedhore të Ligjit mbi Shërbimin Civil, dhe duke ndihmuar në hartimin e legjislationit të ri, duke i'u përgjigjur çështjeve të të drejtave të njeriut, dhe duke shqyrtuar atë të Romëve. Një fushë e re madhore e përfshirjes mund të vijë me nevojën urgjente të zgjidhjes së çështjes kaotike të pronësisë në Shqipëri dhe legjislationit të tokës i cili përfaqëson një nga pengesat më të mëdha për të afruar investimet. Kjo mund të sjellë së bashku dimensionet ligjore, ekonomike dhe politike të Prezencës, duke përfshirë njohjen vendore të Zyrave Rajonale, në një përpjekje për të pajtuar trajtimet e ndryshme politike për këtë problem konfliktual.

Zyra e Shtypit dhe Informacionit Publik ka arritur sukses të rëndësishëm për zhvillimin e medias, duke përfshirë krijimin e statutit ligjor dhe prezantimin e një pasqyrimi më të ekuilibruar të fushatës zgjedhore nga TV publik dhe disa nga stacionet private. Gjithashtu, ajo ka luajtur një rol heroik për të përgënjeshtuar sulmet e vazhdueshme të njëanshmërisë

politike kundër ODIHR-it nga shtypi i kontrolluar prej opozitës. Por, procesi i edukimit të medias për adoptimin e një sjellje më të përgjegjshme sapo ka filluar dhe Zyra e Shtypit do të duhet të zgjerohet më tej marrëdhëniet e konfidencës dhe besimit profesional, për të cilat ajo ka punuar kaq shumë për t'i vënë në jetë.

Është bërë një punë gjithmonë e më rëndësishme nga Oficerja e OJQ-ve/Çështjeve të Gjinisë në zhvillimin e rolit të OJQ-ve në Shqipëri dhe në krijimin e qendrave burimore për to, në pesë nga vendndodhjet e Zyrave Rajonale. Tani, vëmendja është përqëndruar në programet e trainimit për gratë parlamentare, në çështjet gjinore për akademitë e policisë, një projekt për të drejtat e grave dhe anti-trafikun në tre vendodhje pilot, dhe konferenca të ardhshme mbi nevojat ekonomike dhe shoqërore të grave që jetojnë në shoqërinë rurale.

Gjithashtu, roli i Oficeres së Mjedisit po zgjerohet. Ajo ka qenë e angazhuar nga afër në organizimin e konferencës së parë mbi çështjet e mjedisit dhe ekologjisë në Shqipëri, e cila përfaqëson një fushë të rritjes së interesit publik, ndonëse ende nuk njihet si e tillë nga Qeveria. Këtu ajo ka luajtur një rol në informimin e Parlamentarëve për mënyrat e *lobbying* për një Ministri të Mjedisit në Shqipëri. Oficerja e Mjedisit të OSBE-së është gjithashtu një anëtare aktive e Grupit të Strategjisë për Reduktimin e Varfërisë i cili bashkë-drejtohet nga Qeveria e Shqipërisë dhe Banka Botërore. Ndhimesa e saj është veçanërisht e vlefshme për këtë Grup sepse përmbajtja e saj ofrohet nga rrjeti rajonal unik i OSBE-së.

Unë i jam referuar më tepër se një herë rolit të domosdoshëm që luajnë dhjetë Zyrat Rajonale për të përmbushur mandatin e Prezencës. Ato janë më tepër se sytë dhe veshët tanë jashtë Tiranës. Praktikisht, ato përfaqësojnë trupin e Prezencës në Shqipëri dhe janë të njohura si nga qeveria qendrore, ashtu edhe nga autoritetet vendore të cilat i'u drejtohen atyre për këshillim për një sërë problemesh. Në një vend ku ka ende shumë pak konsensus politik dhe besueshmëria ndaj autoriteteve po kthehet me vështirësi, nuk ka dyshim se Zyrat Rajonale kanë një rol stabilizimi për të luajtur. Une jam i sigurtë se Ambasadorët e Shteteve të Bashkuara, Gjermanisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, të cilët u informuan së fundi mbi aktivitetet e tyre nga Kryetarët e katër prej Zyrave tona Rajonale, tani do të kenë një pamje më të mirë përse i'u përket vlerave të tyre. Unë i'u jam mirënjohës për autoritetin e dhënë për hapjen e zyrave të reja në Fier në qershor dhe në Berat në korrik. Nëse, ashtu siç shpresoj, me lejen e Qeverisë shqiptare, do të bëjmë të njëjtën gjë në Lezhë, atëherë ne do të jemi të pranishëm në të gjitha prefekturat jashtë Tiranës.

Unë e kam lënë në fund dimensionin e mandatit të Prezencës i cili konsiderohet nga Komuniteti Ndërkombëtar si i një rëndësie të veçantë, i cili është ofrimi i kuadrit fleksibël të bashkërendimit për asistencën ndërkombëtare. Në fjalimin tim për Këshillin e Përhershëm në qershor, unë fola në detaje për këtë çështje, duke tërhequr vëmendjen për nevojën e harmonizimit midis aktiviteteve bashkërenduese të Miqve të Shqipërisë dhe atyre të një numri të madh organizatash ndërkombëtare, duke përfshirë Bankën Botërore. Unë jam i gëzuar që ne kemi mundësinë të raportojmë se këto probleme potenciale janë në procesin e zgjidhjes dhe bashkëpunimi në rritje midis Bankës Botërore dhe Bashkimit Evropian është tashmë i pasqyruar në kuadrin e bashkëpunimit të Miqve të Shqipërisë. Gjithashtu, ne kemi një marrëdhënie shumë favorizuese me Këshillin e Evropës.

Tani, Miqtë po trajtojnë 28 sektorë të ndryshëm të bashkëpunimit, që nga reforma juridike dhe anti-korrupsioni, deri tek mjedisi dhe çmilitarizimi. Kjo është një gamë shumë e gjerë e subjekteve dhe duke qenë se shumë prej tyre janë të një natyre ligjore, apo kërkojnë

informacion ligjor, ne kemi nevojë për shërbimet e një juristi tjetër ndërkombëtar. Në të njëjtën kohë, Ko-ordinatori i vetëm i Miqve të Shqipërisë, i cili organizon të gjitha takimet me palët e interesuara, kujdeset për axhendat dhe kontributet në to, si dhe përgatitjen e të gjitha proces-verbaleve, po mban kështu një ngarkesë pune të të papërballueshme. Përveç kësaj, ai duhet të monitorojë Iniciativat e Paktit të Stabilitetit, të mirëmbajë faqen e internetit dhe të qëndrojë i informuar për të gjitha ndryshimet në sektorët që kanë të bëjnë me Miqtë. Unë shpresoj se ju do ta shikoni me përparësi kërkesën tonë për një asistent me kohë të plotë brenda buxhetit të vitit tjetër.

Aktualisht, Prezenca po punon mbi kapacitetin e saj për të arritur kërkesat e mandatit dhe ka filluar të ndjejë tensionin. Por këtu nuk bëhet më fjalë për “fleksibilitet”. Unë e kam provuar t’ju jap një pasqyrë të prioriteteve tona dhe kjo do të përcaktohet më tej në dokumentin për strategjinë e Prezencës, rreth së cilës ne jemi duke punuar. Ndërkaq, ne po i ndjejmë efektet e ngushtimeve buxhetore, ku një nga ato është pamundësia për të marrë pjesë në takimet ndërkombëtare. Faktikisht, buxheti ynë u shkurtua në mënyrë drastike në fillim të vitit. Përveç kësaj, ne i’ a kemi arritur të hapim katër Zyra të reja Rajonale dhe i kemi menaxhuar ato gjatë gjysmës së dytë të këtij viti me një kosto totale vjetore prej vetëm \$100,000 për secilën, me një kontribut të vogël shtesë. Kjo do të thotë se është vonuar shumë punë investuese dhe duhet marrë parasysh fakti se misioni, tashmë, po mbush tre vjet dhe disa nga mjetet fillestare kanë nevojë për t’u zëvendësuar. Unë besoj se situata e ardhshme financiare do të merret në konsideratë në mënyrë të favorshme.